




---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK



---

# KODI I ETIKËS I INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK

---

KODI I SJELLJES



TIRANË, 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 486 prot.

Tiranë, më 15.4.2020

URDHËR

Nr. 54 Datë 15 / 4 /2020

PËR

“MIRATIM TË KODI TË ETIKËS TË INSTITUTIT SHËNDETIT PUBLIK”

Në mbështetje të ligjit nr. Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr.9131, datë 8.9.2003 “Per Rregullat e Etikes në Administraten Publike”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Kodit Etik të Institutit të Shëndetit Publik.
2. Ngarkohet për zbatimin e Kodit Etik të gjithë punonjësit e Institutit të Shëndetit Publik.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR  
Albana Fico



Punoi: Erisa Luzi, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Kopje: \_\_\_\_\_

## KODI I ETIKËS

### INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

#### Parimet e Praktikës Etike në Shëndetin Publik

1. Shëndeti publik duhet të angazhohet në parim me shkaqet themelore të sëmundshmërisë dhe kërkesat për shëndet, me synim parandalimin e efekteve të padëshirueshme shëndetësore.
2. Shëndeti publik duhet të përfshij shëndetin komunitar në mënyrë që t'i respektoj të drejtat e individëve në komunitet.
3. Politikat e shëndetit publik, programet, dhe prioritet duhet të zhvillohen dhe vlerësohen nëpërmjet proceseve që sigurojnë një mundësi për pjesëmarrje nga antarët e komunitetit.
4. Shëndeti publik duhet të mbroj ose të punoj për fuqizimin e, mos heqjes së të drejtave të antarëve të komunitetit, duke siguruar burimet bazë dhe kushtet e nevojshme për shëndetin të jenë të aksesueshme për të gjithë njerëzit në komunitet.
5. Shëndeti publik duhet të kërkoj informacionin e nevojshëm për të implementuar politikat dhe programet efektive për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin.
6. Institucionet e shëndetit publik duhet të sigurojnë komunitetet me informacionin që ata kanë nevojë për vendimarrje mbi politikat ose programet dhe duhet të fitojnë pëlqimin e komunitetit për implementimin e tyre.
7. Institucionet e shëndetit publik duhet të veprojnë në kohë mbi informacionin që ata kanë brenda burimeve të disponueshme dhe mandatit të dhënë atyre nga publiku.
8. Programet dhe politikat e shëndetit publik duhet të përfshijnë përjasje të ndryshme dhe të mirëpresin dhe respektojnë vlerat, besimet, dhe kulturat e ndryshme në komunitet.
9. Programet dhe politikat e shëndetit publik duhet të implementohen në mënyrën që të përmirësoj mjedisin fizik dhe social akoma me tepër.
10. Institucionet e shëndetit publik duhet të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit që mund të sjelli dëm për individin ose komunitetin nëse behet publik. Përgjashtimet mund të justifikohen mbi bazat kur interesi publik mbizotron mbi atë privat.
11. Institucionet e shëndetit publik duhet të sigurojnë kompetenca profesionale të punonjësve të tyre.
12. Institucionet e shëndetit publik dhe punonjësit e tyre duhet të përfshihen në bashkëpunimet dhe antarësimet në mënyrat që ndërtojnë besimin publik dhe efektivitetin e institucionit.



## **KODI I ETIKES**

Punonjesit e ISHP duhet të respektojnë Kodin e Punës dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë si edhe Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” si edhe Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”.

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qellimi**

- Kodi i Etikës është një bashkësi parimesh dhe rregullash që duhet të respektohet nga punonjesit e ISHP: kerkues, staf teknik, dhe administrativ.
- Kodi i Etikës vendos rregullat e sjelljes së punonjesve të ISHP, sipas standarteve të kerkuara, t'i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standarteve dhe të verë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë punonjësi i ISHP.
- Punonjesit e ISHP duhet të respektojnë rregulloren e brendshme të institutit.

##### **Neni 2**

##### **Misioni**

Misioni i Institutit të Shëndetit Publik është përcaktuar sipas LIGJ Nr.10 138, datë 11.5.2009 “PËR SHËNDETIN PUBLIK”.

##### **Neni 3**

##### **Parimet e Shëndetit Publik**

Parimet bazë të shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) përgjegjësi kolektive për shëndetin;
- b) roli udhëheqës i shtetit në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës;



- c) shtrirja e veprimeve në tërë popullatën;
- ç) shpërndarja e efekteve të veprimeve në mënyrë të barabartë, në të gjitha grupet e popullatës;
- d) përqendrimi në përcaktuesit socialë të shëndetit;
- dh) përqendrimi në faktorët risk për shëndetin e popullatës, në bazë të fakteve;
- e) përqasja shumëdisiplinore;
- ë) partneriteti me tërë popullatën.

#### **Neni 4**

##### **Zbatimi**

- Per te bere te mundur zbatimin e Kodit te Etikes do te merren te gjitha masat per berjen publike te tij, perfshire ketu edhe perdorimin e website-it te ISHP.
- Shkeljet per mos zbatimin e Kodit te Etikes do te monitorohen dhe masa do te merren sipas dispozitave te meposhtme.

#### **KREU II**

#### **MIRESJELLJA, VESHJA DHE SIGURIA E PUNES**

#### **Neni 5**

##### **Komunikimi dhe Sjellja**

- Punonjesit e ISHP duhet te respektojne kodin e miresjelljes me qytetarët që u shërben, dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij:
  - pa shprehur dhe pa bere abuzime seksuale ne ambjentet e punes,
  - pa aplikuar metoda dhe komunikim denigrues,
  - pa ushtruar dhunë fizike dhe verbale:
    - pa bërtitur me zë të lartë dhe pa fyer me sharje ofenduese qe lidhen me faktorë te paligjshem,
    - pa u zënë fizikisht,
    - pa goditje me sende të forta,
- Punonjesit e ISHP nuk duhet te tolerojne ngacmimet qe kryhen ndaj tyre bazuar ne dallimin racial, besimin fetar, kombesine,

3



etnine, seksin, privatesinë, invaliditetin, gjendjen civile, apo mbi c'do lloj lloj ceshtje qe mbrohet nga ligjet shtetërore.

- Punonjesit e ISHP në procesin e komunikimit dhe vendim-marrjes duhet te respektojnë ne parim hirarkine institucionale.

## **Neni 6**

### **Veshja dhe Paraqitja e Jashtme**

- Punonjesit e ISHP duhet te kene nje veshje normale dhe brenda normave te lejueshme konform vendit të punës:
  - Laburantet dhe mjeket qe punojne ne laboratoret e ISHP duhet te respektojnë kodin e veshjes me perparse te bardha pune.
  - Nuk lejohen veshjet me rripa te holle: si kanatiere, barkun perjashta, etj.
  - Nuk lejohen minifunde shume te shkurtera, si edhe veshje ekstravagante.
  - Nuk lejohen te vishen pantallona te shkurtera ne ambjentet e punes.
- Punonjesit e ISHP duhet te jene te paraqitshem higjenikisht dhe te ruajne pastertine personale.

## **Neni 7**

### **Ndalimi i Pijeve Alkolike dhe Substanca te Tjera**

- Punonjesit e ISHP duhet te mos perdorin substanca alkolike, duhan, apo substanca narkotike te llojeve te ndryshme gjate orarit te punes ne ambjentet e brendeshme te institutit.

## **Neni 8**

### **Siguria në Punë**

- Punonjesit e ISHP duhet te respektojnë rregullat e brendshem dhe standartet e laboratoreve perkates, si ato te sigurise se larte dhe ambjentet neper departamente.



- Punonjesit e ISHP ndalohen të komunikojnë me ze të lartë brenda ambjenteve të institutit që sjell shqetësim dhe pengon berjen e punës në kushte normale.

### **KREU III**

#### **KONFLIKTET E INTERESAVE**

##### **Neni 9**

##### **Shmangia e Konfliktit të Interesave**

- Punonjesit e ISHP duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojnë asnjehere pozitën për interesat e tyre private.
  - Shmangia e konfliktit të interesave bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
- Punonjesit e ISHP lejohen të marrin pjesë në veprimtari sindikale ose të përfaqësimit të punëmarresve, si edhe në veprimtarite mesimdhënëse, kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës.


### **KREU IV**

#### **KOFIDENCIALITETI, MEDIA DHE E DREJTA E AUTORIT**

##### **Neni 10**

##### **Kofidencialiteti**

- Punonjesit e ISHP duhet të ruajnë kofidencialitetin e informacionit që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".
- Punonjesit e ISHP duhet të ruajnë kofidencialitetin e të dhënave personale bazuar mbi Ligjin Nr. 8517, datë 22.07.1999 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale."
- Punonjesit e ISHP pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdorin informacionin kofidencial të marrë gjatë kryerjes së detyrës për interes personal.

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "INSTITUTI SHQIPTAR I SHËNDESI" around the perimeter. To the right of the stamp, the number "5" is printed.

## **Neni 11**

### **Marrdheniet me Median dhe Publikimet**

- Punonjesit e ISHP ndalohen të bëjnë deklarime, shkrime apo publikime që demtojnë apo denigrojnë imazhin e ISHP apo të personelit të saj pa fakte në të mirë të interesit të gjere të publikut.
- Punonjesit e ISHP lejohen të bëjnë deklarime në median e shkruar, vizive dhe elektronike, në baze të informimit të publikut për funksionet baze të ISHP dhe rolin të saj mbi sëmundshmerine dhe masat parandaluese për shëndetin e popullatës në përputhje me Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”.

## **Neni 12**

### **E Drejta e Patentave dhe Autorit**

- Punonjesit e ISHP duhet të respektojnë ligjet në fuqi për të drejtën e patentave dhe autorit shpallur me Ligjin nr.5825, datë 29.7.2008 “Mbi Pronesine Industriale”.
- Nëse një punonjes shkel normat e së drejtës së autorit, detyrohet të demshperblejë mbajtesit e së drejtës.

## **KREU V**

### **KOHA E PUNES DHE MASAT DISIPLINORE**

## **Neni 13**

### **Koha e Punes**

- Punonjesit e ISHP duhet ta përdorin kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.



6

## **Neni 14**

### **Masat Disiplinore**

- Punonjësit e ISHP qe shkelin parimet e etikes te percaktuara ne kete kod etike, kur veprimet e tyre nuk perbejne veper penale, ndeshkohen me masat disiplinore sipas procedures se percaktuar me legjislacionin per statusin e nenpunesit civil.
- Punonjësit e ISHP qe thyëjne disiplinën ne pune ndeshkohen me keto masa sipas Kodit te Punes:
  - a) Vërejtje me gojë për pushim ose largim nga puna
  - b) Dy vërejtje me shkrim me paralajmerim për pushim ose largim nga puna.
  - c) Largim nga puna.

Me thyerje të disiplinës në punë kuptojmë largimet pa leje për punë personale gjatë orarit të punës, ose krijon dëm ekonomik si rezultat i mungesave pa arsye.

## **Neni 15**

### **Hyrja ne Fuqi**

- Ky kod i etikes hyn ne fuqi ne perputhje edhe me rregulloren e brendeshme dhe mund te ndryshoj ne te ardhmen, sipas nevojave dhe interesave te shprehura nga palet e interesuara dhe me miratim te Drejtorit te ISHP.
- Ky kod i etikes hyn menjehere ne fuqi me miratimin e Ministrit te Shendetesise.



Handwritten signature and blue circular official stamp of the Ministry of Health of Albania.